

FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 187, FDH-23816; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex. 4D00096, FDH-33049.

Rexhep (Shaban) Sadiku

(2.04.1954, shqiptar nga Nivokazi/Nivokaz, komuna e Gjakovës/Đakovica, arsimtar, nëntë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Rexhepi ka qenë arsimtar i gjuhës shqipe në shkollën fillore në Moliq/Molić. U inkuadrua në UÇK nga mesi i muajit prill të vitit 1998, në fshatin Smolicë/Smonica. U angazhua në trajnimin e pjesëtarëve të rinj të UÇK-së. Ka rënë gjatë sulmit të forcave serbe ndaj fshatit **Nivokaz**, më **29.05.1998**. Po atë ditë, e varrosën në varrezat lokale të këtij fshati.

Burimet: H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 182, FDH-23816; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Lush (Sadri) Zhubi

(26.06.1935, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, mekanik, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Herët në mëngjes, më 24.04.1998, Lushi u largua me familjen e vet nga apartamenti në Rrugën *Dimitrije Tucović* numër 38 në Gjakovë/Đakovica, sepse një ditë më herët policia serbe e ka bastisur këtë familje dhe e ka kërcënuar bashkëshorten e Lushit, Lirinë, se do ta vriste. U strehuan në Smolicë/Smonica, ndërkaq Lushi, po atë ditë, u paraqit në shtabin lokal të UÇK-së. Në datën 27.05.1998, Lushi me Lirinë kanë shkuar në Baballoq/Babaloc për ta vizituar vëllain e plagosur të Lushit, Xhemën. Pesë ditë më vonë, më 2.06.1998, ata nga Baballoq/Babaloc u nisën për në Shqipëri. Kur arritën në fshatin **Firajë/Firaja**, një predhë eksplodoi jo shumë larg nga ta dhe e plagosi Lushin në fytyrë, gjoks dhe duart. Në fshatin Dujakë/Dujak, ata u strehuan në shtëpinë e familjes Bushati, ku mikpritësit i pastruan plagët e Lushit. Të nesërmen, më **3.06.1998**, ata e vazhduan rrugën për në Shqipëri, por te mali Padesh/Padeš, Lushi ndërroi jetë nga plagët e rënda. Pjesëtarë të UÇK-së nga shtabi në Bajram Curr

[Shqipëria] e kanë varrosur Lushin në varrezat e atjeshme, ku ai prehet edhe sot.

Burimet: deklarata L.Z, FDH-29925; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 197, FDH-23816.

Haxhi (Halil) Hoti

(2.04.1967, shqiptar nga Rogova/Rogovo, komuna e Gjakovës/Đakovica, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Në vitin 1987, Haxhiu ka shkuar në Zvicër për punë. Atje, ai u inkuadrua në Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin e Kosovës. Në Kosovë u kthye në vitin 1997. E themeloi njësitin e UÇK-së për rajonin e *Rogovës së Hasit*, i cili ka qenë i ngarkuar me detyrën e sigurimit të kalimit të papenguar të pjesëtarëve të UÇK-së dhe armatimeve nga Shqipëria për në Kosovë, përmes malit *Pa-shtrik/Paštrik*. Haxhiun luftëtarët e quanin Komandant Lleshi. Në datën 6.06.1998, ai ka shkuar me një grup pjesëtarësh të UÇK-së në Shqipëri për të marr një ngarkesë të re armatimesh. Në kthim, më **8.06.1998**, në fshatin **Gërçinë/Grčina**, te vendi i quajtur *Maja e Kurorës*, ata kanë rënë në pritë të forcave serbe. Haxhiun e qëlluan me dy plumba në gjoks. Gjeti vdekjen në vend. Pjesëtarët e forcave serbe e kanë bartur trupin e tij në morgun e spitalit të Gjakovës/Đakovica. Dy ditë më vonë, axha i Haxhiut, Hamza, me kushërinjtë Hazerin dhe Naserin e kanë marrë trupin e viktimës dhe e kanë varrosur në varrezat e Rogovës/Rogovo.

Burimet: deklarata R.H, FDH-29788; SHFDUÇK, *Feniksët...*, 7, 105-110.

Vladimir (Mateja) Ratković

(12.03.1976, serb nga Beogradi, pjesëtar i UJ-së)

Në fillim të muajit maj të vitit 1998, Vladimiri gjendej në kryerjen e shërbimit të rregullt ushtarak në kazermën *Pantelej* në Nish [Serbi]. Më pas, atë e transferuan në Gjakovë/Đakovica, ku e ka kryer një trajnim të shkurtër për ngasjen e autobлиндës të quajtur *Praga*. Detyra e tij e rregullt ishte që të angazhohej në Ponošec/Ponoševac, ku kishte konflikte të herëpashershme me shqiptarët, të cilët i transportonin armatimet nga Shqipëria në Kosovë. Në